



arkiv ose me postë elektronike: grizazakorisnici@khigiena.com.mk ose përmes formularit Raporto problem në faqen e internetit të NP Higjiene Komunale - Shkup www.khigiena.com.mk.

PYETJET QË PARASHTROHEN MË SË SHPESHTI

Dua të rinovoj apartamentin, por nuk e di se ku të drejtohem për mbledhjen e mbeturinave të ndërtimit që do të krijohen?

NP Higjiene Komunale - Shkup u ofron qytetarëve shërbimin për grumbullimin dhe transportimin e këtij lloji mbeturinash, me automjete speciale të kompanisë. Qytetarët mund ta kërkojnë këtë shërbim në linjën telefonike falas - 080022233 dhe çmimi i shërbimit është 950 denarë (pa TVSH).

Jam pronar i shtëpisë në të cilën askush nuk jeton. A duhet të paguaj faturën e mbeturinave duke pas parasysh që nuk e përdori shërbimin?

Nëse jeni pronar i shtëpi dhe askush nuk jeton në të, keni mundësinë të aplikoni për lirim nga detyrimi për të paguar kompensimin për grumbullimin e mbeturinave, shërbim të cilën në të vërtetë nuk e përdorni sepse nuk krijoni mbeturina. Sipas kriterëve të brendshme të NP Higjiene Komunale, ekziston mundësia që të liroheni nga pagimi i detyrimit, por vetëm 50% të shumës që jeni duke e paguar aktualisht.

Kam humbur punën time dhe për disa vjet nuk isha në gjendje të paguaj faturat e për mbeturinat. Tani, përveç borxhit kryesor, duhet të paguaj edhe shpenzime dhe kamata. A do të mund, tani me aksionin të cilin po e paralajmëron NP Higjiene Komunale, të paguaj borxhin pa interes, por në disa këste?

Fatkeqësisht, aksioni për arkëtim të borxheve të cilin e realizon NP jep mundësi për t'u liruar nga interesi vetëm nëse borxhin dhe shpenzimet i paguani plotësisht, përkatësisht nuk keni mundësi për t'i shlyer ato këste.

Ka disa ditë që prapa ndërtesës sime gjendet cofëtina e një qeni të helmuar. Përveç erës së keqe që përhapet, aty afër ka edhe një kënd me lojëra për fëmijë, prandaj kam frikë se fëmijët do ta prekin. Ku duhet të drejtohem për ndihmë, përkatësisht kush është përgjegjës për heqjen e trupit të qenit?

Duhet të drejtoheni te NP Higjiene Komunale - Shkup, në telefonin kujdestar (02) 3 216 644. Shërbimet e kanë për detyrë të intervenojnë, ndërsa automjeti për kapjen dhe transportimin e qenve endacakë në Vardarishte, përdoret edhe për të ngritur kufomat e kafshëve të ngordhura. nga rrugët e Shkupit.

Ankesat më të shpeshta nga konsumatorët drejtuar Avokatit të Popullit lidhur me shërbimet e NP Higjiene Komunale

- Pranim të faturave për mbledhjen e mbeturinave edhe pse shërbimi nuk është shfrytëzuar (nuk janë vendosur kontejnerë dhe mbeturinat nuk janë mbledhur rregullisht);
- Arkëtim i shërbimit për grumbullim të mbeturinave nga pronar i pronës, e cila nuk përdoret për vendbanim të përhershëm, përkatësisht askush nuk jeton aty.



- Probleme që kanë lindur për shkak të informacioneve jo të plota që janë pranuar nga ndërmarrja publike që kanë të bëjnë me ekzistencën e ndonjë borxhi të papaguar;
- Kërkesat për të bërë matje të re të sipërfaqes së objektit të banimit si bazë për arkëtim të mbledhjes së mbeturinave.

Nëse si konsumatorë nuk jeni të kënaqur nga përgjigja e NP Higjiene Komunale për ankesën tuaj, mund të drejtoheni në:

- Inspektoratin Shtetëror komunal, tel. 02 2465 322, e-mail: kontaktdki@dki.gov.mk ose me plotësim të kontakt-formë në www.dki.gov.mk;
- Komisionin Shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në fushën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës për kundërvajtje, tel. 02 3211 343, e-mail: drzavnakomisija@gmail.com ;
- Avokati i Popullit të RMV-së, tel. 02 3129 335, e-mail: kontakt@ombudsman.mk ose duke plotësuar kontakt-formularin në www.ombudsman.mk;
- Kundër aktvendimeve të prera (përfundimtare) të ndërmarrjeve publike mund të iniciohet edhe kontest administrativ pranë Gjykatës administrative me padi;
- Për mosrespektim të obligimeve nga marrëveshja me ndërmarrjen publike mund të mbahet procedurë pranë gjyqit të rregullt (civil), që iniciohet me padi me të cilën kërkohet të respektohen dispozitat kontraktuese dhe nëse për shkak të mosrespektimit ka ndodhur dëmi konkret, mund të kërkohet edhe kompensim i dëmit;
- Këshilli për mbrojtje të konsumatorëve të Qytetit të Shkupit, bul. Ilinden numër 82 - Shkup;
- Organizatën e konsumatorëve të Maqedonisë, tel. 02 3179 592, e-mail: sovetuvanja@opm.org.mk ose duke plotësuar kontakt-formularin në www.opm.org.mk.

KJO BROSHURË U PËRGATIT NGA:

KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE TË QYTETIT TË SHKUPIT

Bul. Ilinden, nr. 82- Shkup
potrosuvaci@skopje.gov.mk
<http://www.skopje.gov.mk>

ORGANIZATA E KONSUMATORËVË TË MAKEDONISË OKM - Shkup

Rr. Divizioni 50, 10A Shkup
 Për këshillim kontaktoni:

sovetuvanja@opm.org.mk, ose në platformën e këshillimit në uebfaqen <http://www.opm.org.mk>



Qyteti i Shkupit



KËSHILLI PËR MBROJTJE
TË KONSUMATORËVE

CILAT JANË TË DREJTAT dhe OBLIGIMET E KONSUMATORËVE PËR SHËRBIMET TË CILAT I JEP NP HIGJIENA KOMUNALE - SHKUP

Me siguri keni vërejtur që mbeturinat nuk mblidhen rregullisht para ndërtesës suaj, kontejnerët janë me mbeturina të hedhura gjithandej ose të prishur, në lagjet me shtëpi individuale mbeturinat në vend të dy herë grumbullohen një herë në javë, në lagjen tuaj ka numër të vogël kontejnerësh për mbeturina, ndonjëherë kontejnerët dëmtohen ose shkatërrohen nga persona të panjohur apo koshat që janë brenda këndeve me lojëra për fëmijë janë vazhdimisht të mbushur dhe sigurisht vini re që në shumë vende të qytetit përnjëherë shfaqen deponi të paligjshme të mbeturinave të ndërtimit dhe shumë dukuri të tjera që nuk përmenden këtu, e që janë të lidhura me higjienën e qytetit.

Në situata të tilla dhe të ngjashme duhet të reagoni menjëherë, sepse përveç detyrimit për të paguar rregullisht shërbimin për punë komunale në Qytetin e Shkupit, duhet të reagojmë ndaj të gjitha rrethanave që e çrregullojnë higjienën dhe ashtu kontribuojmë që shtëpia, ambienti dhe qyteti ynë të jetë më i pastër, më të rregulluar.

Për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me: mbledhjen e mbeturinave komunale, pastrimin e hapësirave publike, pastrimin e deponive tpastrimin paligjshme, selektimin dhe ndarjen e mbeturinave, trajtimin human tpastrimin kafshpastriminve endacake dhe mbledhjen e cofëtinave (karkaseve) të kafshëve të ngordhura nga vendet publike, mund të drejtoheni te shërbimet e NP HIGJIENA KOMUNALE.



CILAT JANË RREGULLAT THEMELORE PËR MBLEDHJE TË MBETURINAVE KOMUNALE?

Dinamika e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave komunale nga rajoni i qytetit të Shkupit përcaktohet varësisht nga:

- dendësia e popullsisë;
- sasia e mbeturinave të gjeneruara komunale;
- struktura e mbeturinave komunale;
- kushtet infrastrukturore të trafikut;
- lloji dhe numri e kontejnerëve të vendosur për mbeturina komunale.

Për grumbullimin dhe transportin e plotë të mbeturinave komunale, sipas dinamikës së përcaktuar, rajoni i qytetit të Shkupit është e ndarë në një numër përkatës të blloqeve që është përfshirë në planin e përgjithshëm urbanistik.

SI PËRLLGARITET KOMPENSIMI PËR SHËRBIMIN E NP HIGJIENA KOMUNALE?

Për personat fizikë në ndërtesë banimi kolektive, për përllogaritje merret parasysh shuma e këtyre hapësirave:

- Sipërfaqja neto e banesës me të gjitha dhomat shtesë - ndihmëse, përkatësisht (tarracat, kthinat, etj.), e të cilat janë përbëjnë njësi të vetme të banesës;
- Sipërfaqja neto e bodrumit;
- Sipërfaqja neto e garazhit, gjegjësisht hapësira parkimi nëntokësore dhe
- Sipërfaqja e përbashkët e ndërtesës së banimit kolektiv si shkallët, korridorët, etj., që kap vlerën e 10% të neto sipërfaqes së banesës.
- Për një person fizik (amvisëri) në ndërtesë individuale banimi, merret parasysh shuma e sipërfaqeve në vijim:
- Sipërfaqja neto e shtëpisë duke marrë parasysh sa kate ka shtëpia dhe të gjitha dhomat ndihmëse, përkatësisht sipërfaqe (tarracat, kthinat, shkallët, bodrumi etj.), e të cilat janë përbëjnë njësi të vetme të shtëpisë;
- Sipërfaqja neto e të gjitha objekteve jashtë përmasave të shtëpisë (garazh, tharqet etj.).

ÇKA BIE NËN KOMPETENCA TË NP HIGJIENA KOMUNALE?

Grumbullimi i mbeturinave voluminoze dhe mbeturinave të ndërtimit

Mbeturinat voluminoze (mobilet, pajisjet e vjetra elektrike dhe elektronike) dhe mbeturinat e ndërtimit nuk duhet të hidhen nga konsumatorët në kontejnerë ose afër tyre.

Për të siguruar një mënyrë më të lehtë për t'u liruar nga mobilet e panevojshme, Higjiena Komunale e NP, në bashkëpunim me komunat dhe Qytetin e Shkupit, organizon aksione për mbledhjen e mbeturinave voluminoze.

Komunat i mbledhin këto lloj mbeturinash falas në aksione të organizuara dy-ditore që zhvillohen katër herë në vit në secilën komunë.

Në kuadër të këtyre aksioneve, qytetarët të cilët duan të hedhin mobilet e vjetra dhe pajisjet e panevojshme elektrike dhe elektronike kanë mundësinë që në periudhën prej orës 7 deri në orën 9.30 të mëngjesit t'i depozitojnë këtë lloj mbeturinash para shtëpive të tyre, e pas kësaj kalojnë automjetet speciale komunale që i ngrenë, sipas orarit të parapërgatitur nga bashkësitë lokale.

Përveç aksioneve të organizuara në komunat e Shkupit, NP Higjiena Komunale – Shkup ka filluar me një shërbim të ri për grumbullimin e mbeturinave voluminoze prej brenda shtëpisë, pavarësisht nëse është amvisëri individuale apo amvisëri kolektive. Qytetarët të cilët kanë nevojë të heqin të lirohen nga mobilet e tyre të vjetra dhe pajisjet e papërdorshme elektronike dhe elektrike mund të telefonojnë në numrin pa pagesë 0800 222 33 ta porositin shërbimin për marrjen dhe transportimin e mbeturinave me automjete speciale të ndërmarrjes.

Sipas listës së çmimeve, marrja dhe transportimi i mbeturinave voluminoze prej brenda shtëpisë kushton 2.800.00 denarë, nxjerrja e saj nga dera 2.000.00 denarë, dhe heqja e mbeturinave të mëdha pa punëtorë, pra vetëm automjeti i kompanisë kushton 1.600.00 denarë.

Hedhja e mbeturinave të mëdha është falas në pikat e kompanisë në Qendrën për selektiv të mbeturinave në Karposh, në blvd. Ilinden (prapa stacionit të karburantit MAKPETROL, në Karposh 3) dhe Vardarishte.

Gjithashtu, mbeturinat e ndërtimit që gjenerohen gjatë ndërtimit ose rinovimit të shtëpive, qytetarët nuk duhet të hedhin në koshat e mbeturinave - kontejnerë.

NP Higjiena Komunale - Shkup u ofron qytetarëve shërbimin për grumbullimin dhe transportimin e këtij lloji mbeturinash, me automjetet speciale të kompanisë.

Pastrimi i sipërfaqeve të trafikut publik

Pastrimi i sipërfaqeve të trafikut publik nënkupton mirëmbajtjen e higjienës komunale publike duke i pastruar dhe larë rrugët, si dhe duke zbratur koshat për mbeturina.

Trajtimi i ujërave fekale

Meqenëse në Shkup ende ekzistojnë objekte të personave fizikë që nuk janë të të përfshirë nga sistemi i rrjetit të kanalizimeve, NP Higjiena Komunal kryen një shërbim të pastrimit të fekalëve dhe ujërave fekale nga rezervuarët septikë, me thirrjen e shfrytëzuesve.

Shpesh ndodhë që automjetet e dedikuara për pastrimin e rezervuarëve septikë të kryejnë shërbime nëpër njësi të banimit dhe objekte tjera kur ka përmytje, të shkaktuara nga shirat e rrëmbyeshëm, sepse rrjeti i kanalizimeve atmosferike nuk është në gjendje të pranojë krejt ujin nga sipërfaqet e trafikut publik.

Njësitë e banesave dhe shtëpitë individuale mund të përmyten nga derdhja e ujit jashtë shtretërve të lumenjve në rajonin e qytetit të Shkupit. Gjithsesi, dukuritë e tilla janë më të shpeshta në pjesët rurale të komunave të Qytetit të Shkupit.

Furnizimi i ujit për persona fizikë dhe juridikë

NP Higjiena Komunale e ka për obligim të sigurojë ujë të pijshëm deri te vendbanime të caktuara, në rastet kur është e domosdoshme, për të përmbushur nevojat e popullatës. Për këtë qëllim, përdoren cisterna që janë në pajtim me të gjitha standardet për transport të ujit të pastër të pijshëm.

Selektimi i mbeturinave

Selektimi i përbërësve të përdorshëm të mbeturinave komunale në vendin ku gjenerohen ato - përzgjedhja primare, kontribuon ndjeshëm në cilësinë e jetesës urbane dhe uljen e sasive totale të mbeturinave. Ajo sjell përfitime ekonomike dhe rrit vetëdijjen dhe përgjegjësinë e gjeneruesve të mbeturinave dhe dhënësve të shërbimeve.

Gjendja aktuale në trajtimin e mbeturinave komunale paraqet selektiv primar të pjesshëm të: pet ambalazhit, letrës, kartonit dhe kanaçeve. Ky lloj selektimi bëhet në një pjesë më të vogël të qytetit.

KU TË DREJTOHENI NËSE KENI NEVOJË PËR INFORMACION OSE PROBLEM ME SHËRBIMET E NP HIGJIENA KOMUNALE?

Nëse keni një problem si konsumator, problemin mund ta raportoni në telefonin kujdestar të NP Higjiena Komunale - Shkup (02) 3 216 644 çdo ditë pune nga ora 8 e mëngjesit deri në ora 20, në e-mail: khs@khs.com.mk ose mund të vizitoni në faqen e internetit www.khigjiena.com.mk dhe ta paraqitni problemin përmes formularit që ekziston në internet.

Njësia për kujdes ndaj konsumatorëve

Departamenti për kujdes ndaj klientëve në NP Higjiena Komunale-Shkup punon nga e hëna deri të premten, në periudhën nga 07:00 - 19:00, në rr 516 nr. 10 Shkup - Gazi Baba dhe gjatë kësaj kohe konsumatorët mund të vizitohen personalisht Departamentin dhe të informohen për ndonjë shërbim të caktuar ose zgjidhjen e ndonjë problemi që është shfaqur. Po ashtu, si përdorues të shërbimeve keni mundësi të informoheni në mënyrë elektronike, përmes postës elektronike: grizazakorisnici@khigjiena.com.mk. Në të njëjtën kohë, të gjithë formularët e nevojshëm në lidhje me kërkesat e përdoruesve janë publikuar në faqen e internetit: www.khigjiena.com.mk.

Për ata qytetarë që marrin fatura të përbashkëta të NP Higjiena Komunale - Shkup dhe NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi, në Departamentin për kujdes ndaj konsumatorëve është vendosur aparat me të cilën ata mund të realizohet pagesa elektronike të këtyre detyrimeve veç-e-veç.

Konsumatorët mund të bëjnë pagesën e faturave edhe përmes sistemit për pagesa elektronike të NP Higjiena Komunal-Shkup pas regjistrimit paraprak.

Procedura e ankimit

Konsumatorët mund të paraqesin ankesë deri te NP Higjiena Komunale përmes linjës telefonike falas (02) 3 216 644, personalisht duke parashtrua ankesë në